

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7879  
E shtunë, 7 shtator 2024  
Çmimi 0.50

Nis vjelja e rrushit  
me moton "Për kokërr  
të qejfit"



FAQE 8

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

EMISARI SPECIAL I BE-SË, MIROSLAV LAJÇAK, KA TAKUAR TË PREMTEN NË PRISHTINË  
ZËVENDËSKRYEMINISTRIN BESNIK BISLIMI | FAQE 4-5

## LAJÇAKU: URA DUHET TË HAPET, POR NË BASHKËPUNIM ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË



I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë të premtën në Prishtinë, pas takimit me kryenegociatorin e Kosovës për dialog, Besnik Bislimi, se ura mbi lumin Ibër duhet të hapet,

mirëpo në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë të Kosovës. Lajçaku u ka thënë gazetarëve se është arritur pajtim për një raund të ri të dialogut në nivel kryenegociatorësh, por nuk ka

treguar ndonjë datë për mbajtjen e këtij takimi. Ndërkaq zëvendëskryeministri Bislimi ka ritheksuar se hapja e urës kryesore të Mitrovicës mbi Ibër është trajtuar në Bruksel dhe se ajo duhet të hapet

**25 VJET, POLICIA  
VLERËSOHET  
INSTITUCIONI MË  
I BESUESHËM  
PËR QYTETARËT**

F. 3



**MINISTRI I PUNËVE  
TË JASHTME I  
TURQISË THOTË SE  
DO TA MBËSHTESIN  
FSK-në PËR PAJISJE  
USHTARAKE**

F. 5



### AKTUALE



**RISTRUKTURIMI I QEVERISË  
UKRAINASE: ENERGJI E RE APO  
RUTINË?** F. 2

**FAKTORËT QË PO I KONTRIBUOJNË  
DHUNËS ME ARMË ZJARRI DHE SI  
PARANDALOHET AJO** F. 7

**SERBIA KONFIRMON KËRKIMET NË  
NJË VARREZË TË MUNDSHME  
MASIVE PRANË NOVI PAZARIT** F. 5

### EKONOMI



**ÇMIMET E KONSUMIT SHKUAN NË  
1,4 % VJETORE DHE 0,2 %  
MUJORE** F. 8

**ATK-JA RRIJT TË HYRAT PËR  
62.9 MILIONË EURO NË RAPORT ME  
VITIN E KALUAR** F. 8

### SPORT



**KOSOVA PËSON HUMBJE  
TË THELLË NGA RUMANIA** F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Ristrukturimi i qeverisë ukrainase: Energji e re apo rutinë?

**KIEV, 6 SHTATOR** - Në kohën kur pushtimi në shkallë të plotë i Ukrainës nga Rusia është në muajin e 30, presidenti Volodymyr Zelensky po përpiket t'i shkundë disa gjëra si në fushën e betejës, po ashtu edhe në sallat e pushtetit në Kiev.

Në fillim të gushtit Ukraina nisi një inkursion të befasishëm në territorin rus, duke dërguar trupa përtej kufirit dhe duke hapur një front të ri në rajonin e Kurskut.

Këtë javë presidenti ukrainas nisi ristrukturimin më të madh të qeverisë së tij që nga fillimi i luftës gjithëpërfshirëse, duke

zëvendësuar ministrin e Jashtëm - një figurë e shquar e Ukrainës që nga viti 2020 - dhe duke bërë edhe ndryshime të tjera në kabinetin e ministrave dhe në administratën e tij.

Zelensky e zëvendësoi edhe ministrin e tij të Mbrojtjes një vit më parë dhe komandantin e përgjithshëm të forcave të armatosura në shkurt, ndërsa për ndryshime më gjithëpërfshirëse në qeveri ka kohë që flitet.

Kryetari i Parlamentit të Ukrainës, Ruslan Stefanchuk, njoftoi qysh në qershor se do të ketë ndryshime në kabinet, duke kujtuar se disa ministri - përfshirë ato që janë përgjegjëse për kulturën, politikën bujqësore dhe infrastrukturën - janë pa ministra të konfirmuar tash e sa kohë.

Atëkohë nuk ndodhi asgjë. Edhe thashethemet që pasuan, se kryeministri Denys Shmyhal mund të zëvendësohet, rezultuan të pasakta, pasi ai mbetet në detyrë.

Analisti politik Volodymyr Fesenko thotë për Radion Evropë e Lirë se ai beson se Zelensky dhe shefi i tij i kabinetit, Andriy Yermak, kanë dashur prej kohësh të bëjnë ndryshime, por se vetëm tash "kanë gjetur kohë" për të marrë vendime se kush duhet të shkojë ku. "Sapo i kanë marrë vendimet përkatëse politike... [ndryshimet] janë bërë", thotë Fesenko.

Sido që të jetë, ndryshimet vijnë në

një moment intensiv të luftës. Ukraina mban territore në rajonin e Kurskut të Rusisë dhe forcat e Moskës janë duke përparuar në Donbas, përkatësisht në provincat lindore të Donjeckut dhe Luhanskut, të cilat presidenti rus Vladimir Putin duket se është i vendosur t'i pushtojë tërësisht.

Zelensky tha më 4 shtator se Ukraina ka nevojë për "energji të re", ndërsa rikonstruktimin e qeverisë e përshkroi si synim "për ta forcuar shtetin në fusha të ndryshme".

Zelensky, i cili u zgjodh në prill të vitit 2019, tha se disa zyrtarë kanë qenë në postet e tyre për katër vjet e gjysmë apo pesë vjet. Ai bëri thirrje për rezultate të shpejta, duke i kërkuar ekipit të tij të ri të punojë "në mënyrë më aktive se më parë", si dhe të arrijë përparime në investimet në industrinë e armëve, në stabilitetin financiar, në mbështetjen për vijën e frontit dhe në përpjekjet e Ukrainës për anëtarësim në Bashkimin Evropian.



## A do të japë fryte ristrukturimi?

Figura të opozitës shprehën dyshime se ndryshimet në qeveri do të sjellin ndryshime pozitive. "Nuk do të ketë gjak të freskët. Le ta themi troç", tha Yulia Klivenko, ligjvënëse nga partia opozitare Holos, për Shërbimin e Ukrainës të Radios Evropë e Lirë. "Janë të njëjtët njerëz, ata thjesht po i ndryshojnë vendet, po kalojnë nga një ministri në tjetrën", tha ajo.

Rybachuk, në anën tjetër, tha se ministrat kanë pak pushtet, ndërsa "vendimet e vërteta" merren nga njerëz të afërt me Zelenskyn që, sipas tij, "nuk e mbajnë nivelin e duhur të përgjegjësisë për vendimet". "Presidenti thotë se dëshiron të shohë njerëz me energji të re,

profesionistë aktivë por, në të njëjtën kohë, rrethi i tij thotë se ai kërkon që këta njerëz të rinj të kuptojnë më shpejt... dhe t'i përmbushin menjëherë të gjitha tekat e presidentit dhe zyrës së tij", thotë Rybachuk. "Ky, sigurisht, nuk është një model që do të na sjellë rezultate të rëndësishme", shton ai.

Mbështetësit e Zelenskyt thonë se ai është i hapur për njerëz të rinj në qeveri, duke vënë në dukje këtu emërimin e Rustam Umerovit nga partia Holos, ministër i Mbrojtjes, vitin e kaluar.

Fesenko thotë se beson se me "energjinë e re", Zelensky nënkupton ndryshimet brenda ekipeve ekzistuese dhe jo ekskluzivisht "fytyra të reja".

Disa kritikë dyshojnë se ristrukturimi synon ta konsolidojë edhe më shumë pushtetin në duart e Zelenskyt dhe të administratës së tij, duke vënë në dukje faktin se disa prej lëvizjeve përfshijnë kalimin e anëtarëve të kabinetit në zyrën presidenciale ose anasjelltas.

Andriy Sybiha, ish-zëvendësministër i parë i Jashtëm, i cili e zëvendësoi Dmytro Kulebën si kryediplotat ukrainas, ka punuar më herët në zyrën presidenciale.

Ministri i ri i Zhvillimit të Komuniteteve, Territoreve dhe Infrastrukturës, Oleksiy Kuleba, është ish-deputet, ndërsa ish-ministrja për Riintegrimin e Territoreve të Pushtuara Përkohësisht, Iryna Vereshchuk, është zhvendosur në zyrën presidenciale për të punuar në politikën sociale.

Oleh Rybachuk, zëvendëskryeministër i ish-presidentit Viktor Yushchenko dhe

tani udhëheqës i OJQ-së me bazë në Kiev, Qendra UA, thotë se "është e pamundur të flitet për fytyra të reja [në kabinet] sepse ato zgjidhen bazuar në shumë kritere dhe nga grupe të ndryshme të ndikimit". Në këto grupe ai përmend në mënyrë specifike shefin e kabinetit të Zelenskyt, Yermak.

Yermak nuk ka komentuar për rolin e tij në ristrukturimin e qeverisë.

Më herët, në një intervistë me një media ukrainase, ai iu përgjigj pretendimeve se ndërhyr në punën e Ministrisë së Jashtëm duke thënë: "Autoriteti im përfundon aty ku përfundon mandati i presidentit".

Ai, po ashtu, tha se e sheh veten si këshilltar për sigurinë kombëtare. Fesenko ka një qëndrim tjetër prej Rybachukut. "Rezerva e personelit është e kufizuar", thotë ai. Emërimet e reja janë bërë "duke zgjedhur nga ata që e kanë dëshmuar veten në ekipin e Volodymyr Zelenskyt", sipas tij.

## Ushtria izraelite tërhiqet nga kampet e refugjatëve në Bregun Perëndimor

**XHENIN, 6 SHTATOR** - Forcat izraelite duket se janë tërhequr nga Xhenini dhe dy kampe të tjera të refugjatëve në Bregun e pushtuar Perëndimor, pas për më shumë se një javë ushtria kreu operacion ushtarak, që la të vrarë dhjetëra persona. Izraeli thotë se bastisjet në shkallë të gjerë në Bregun Perëndimor synojnë shkatërrimin e grupeve

militante dhe parandalimin e sulmeve. Palestinezët druajnë për një zgjerim të luftës në Gazë.

Gjatë operacionit, zyrtarët e ushtrisë izraelite thanë se kanë shënjestruar militantët në kampin e refugjatëve në Xhenin, Tulkarem dhe Al-Fara, teksa sulmet ndaj civilëve izraelitë së fundi, sipas ushtrisë, janë rritur dhe janë bërë më vdekjeprurëse.

Trupat u tërhoqën nga kampi Tulkarem mëngjesin e së premtes dhe më herët ishin larguar nga Al-Fara. Por, në njoftimin e ushtrisë izraelite u sugjerua se operacioni nuk ka përfunduar ende. "Forcat izraelite të sigurisë po vazhdojnë të veprojnë në mënyrë që të arrihen qëllimet e operacionit kundër terrorizmit", tha ushtria izraelite përmes një deklarate.



# 25 vjet, Policia vlerësohet institucioni më i besueshëm për qytetarët

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Të premten është shënuar 25-vjetori i themelimit të Policisë së Kosovës, në të cilën ceremoni kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve të vendit dhe të sigorisë. Në këtë përvjetor jubilar të themelimit të policisë, për herë të parë është interpretua himni i Policisë së Kosovës.

Ceremonia më pas vijoi me një minutë heshtje në nderim dhe përkujtim të të gjithë policëve të rënë në detyrë përgjatë këtyre 25 vjetëve shërbim të Policisë së Kosovës.

Policia e Kosovës nisi funksionalizimin e shkollës policore në qytetin e Vushtrrisë dhe me trajnimin e menjëhershëm të gjeneratës së parë të pjesëtarëve të Shërbimit Policor të Kosovës.

Në gjeneratën e parë të Policisë së Kosovës diplomuan 176 kadetë, 20% prej të cilëve vajza e gra dhe 17% nga radhët e komuniteteve. "Jam i nderuar që ndodhem sot këtu për të shënuar dhe festuar bashkë me të gjithë ju një çerek shekulli të

ekzistencës dhe zhvillimit të policisë sonë, Policisë së Kosovës, dhe jam i lumtur që mes nesh kemi zyrtarë të gjeneratës së parë të Policisë së Kosovës, të cilët ende i ruajnë të freskëta kujtimet dhe përvojën e asaj kohe. E admirojmë përkushtimin e tyre, që përkundër të gjitha sfidave të asaj kohe, vendosën ta veshin uniformën e të shërbejnë për të gjithë e pa dallim", ka deklaruar kryeministri Kurti në adresimin e tij.

Ai vijoi fjalën e tij duke thënë se veprimet e Policisë sonë në sulmet e njëpasnjëshme në tri vitet e fundit nga grupet kriminale të dirigjuara nga Serbia e veçanërisht në sulmin terrorist të 24 shtatorit të vitit të kaluar në Banjskë të Zvečanit kanë dëshmuar se me profesionalizëm dhe guxim arrihen rezultate në misionin e sundimit të ligjit, mbrojtjes së jetës së qytetarëve tanë e të sovranitetit shtetëror e të integritetit territorial. "Banjska, po ashtu, ka risjellë në mendjet e secilit prej nesh, që pavarësisht çfarëdo aspirate të shfrenuar të kujtdo qoftë mbi Republikën tonë të

dashur, territori ynë do të mbrohet edhe me jetë. Integriteti institucional e zyrtar e personal ruan dhe mirëmban integritetin territorial", shtoi më tej ai.

Kryeministri shprehu mirënjohjen për të gjithë pjesëtarët që edhe sot, si çdo ditë, janë në detyrë anëmbanë vendit tonë, të cilët duke reflektuar mbi betimin e dhënë, kanë dëshmuar që nuk kursejnë as jetën e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së Republikës sonë. "Si kryeministër i Republikës së Kosovës jam krenar e mirënjohës për arritjet e policisë sonë. Shërbimi me integritet dhe reagimi me profesionalizëm, i bazuar në ligjet tona, janë drejtimet mbi të cilat duhet të fuqizohet edhe më tej Policia e Kosovës", tha ai.

Në përmbyllje të fjalës, kryeministri ua uroi të gjithëve 25-vjetorin e themelimit të Policisë së Republikës së Kosovës, atyre që ishin të pranishëm e veçanërisht pjesëtarëve të Policisë që në këto momente janë në shërbim në gjithë territorin e Republikës tonë.

Ndërkaq ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, duke e quajtur këtë si ditë të veçantë për Policinë e Kosovës dhe për mbarë republikën, tha se sot Policia e Kosovës është institucioni më i besueshëm për qytetarët tanë, e ngritur profesionalisht, e trajnuar mirë dhe e gatshme për t'iu përgjigjur çdo rreziku që cenon sigurinë e vendit tonë.

Ministri Sveçla ka kujtuar rënien në krye të detyrës të 23 pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, duke thënë se ata janë pjesa më e lavdishme e policisë dhe e Republikës së Kosovës. "Nga heroi Lazim Rexhepi deri te heroi Afrim Bunjaku, dëshmuar se mbrojnë betimin e dhënë, mbrojnë jetën e pronën e qytetarëve tanë, integritetin e sovranitetin territorial të Republikës së Kosovës me sakrificë të përditshme, me vullnet e përkushtim, qoftë edhe me jetën e tyre", tha ministri Sveçla.

Në këtë 25-vjetor të themelimit të Policisë, ministri përmendi rezultatet e shënuara të Policisë së Kosovës gjatë këtyre katër

vjetëve, si në goditjen e grupeve kriminale, rrjeteve e laborantëve të drogës, terrorizimit, kontrabandës e korrupsionit, mbi të gjitha dhe më e rëndësishmja mbrojtja me çdo çmim e integritetit territorial dhe shtirja e sovranitetit, veçanërisht në veriu e vendit tonë.

Në përmbyllje të kësaj ceremonie, presidentja e vendit, Vjosa Osmani, kryeministri Kurti, ministri Sveçla dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, iu ndanë medalje, mirënjohje dhe lëvdata institucioneve të ndryshme.

Nga viti 2021 në vitin 2024 buxheti i Policisë së Kosovës është rritur për mbi 50 milionë euro të dedikuara për pajisje të modernizuara për pjesëtarët e saj, infrastrukturë në objekte e stacione policore, si dhe automjete e autobllinda speciale sipas nevojave të sigorisë.

Për 25-vjetorin e themelimit të Policisë së Kosovës kanë shkruar edhe liderët e opozitës, të cilët e kanë vlerësuar lart këtë institucion të sigorisë.

## Orban: BE-ja ka nevojë për bashkëpunim të ngushtë për tregje dhe mbrojtje, jo për politikë

Budapest, 6 shtator - Bashkimi Evropian ka nevojë për bashkëpunim më të ngushtë për tregjet dhe mbrojtjen, por jo për çështje politike siç është emigracioni, ku dallimet e mëdha mes vendeve e bëjnë të pamundur një gjë të tillë, tha të premten kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban. "Ka çështje, madje çështje ekzistenciale, për të cilat ne nuk kemi zgjidhje të përbashkëta. Ato janë, lufta dhe paqja, emigracioni, gjinia, shoqëria bazuar në punë dhe punësimi i plotë", tha Orban

në një konferencë në Itali. "Nëse na detyroni të bashkohemi për çështje për të cilat nuk pajtohemi, atëherë kështu e shpërbëni Bashkimin Evropian", tha ai.

Orbani tha se vizitat e tij në Kiev dhe në Moskë në fillim të këtij viti, për të cilat ai u kritikua ashpër nga disa partnerë të BE-së, bënë që ai të vinte në përfundim se "asnjëra palë nuk e ka për qëllim arritjen e armëpushimit tani për tani".

Hungaria, e cila ka mbajtur lidhje të ngushta me Rusinë

prej se Moska e nisi pushtimin e plotë të Ukrainës në shkurt 2022, është duke e mbajtur kryesimin gjashtëmuor të Presidencës së BE-së prej korrikut.

Pasi e mori kryesimin e bllokut, Orbani e vizitoi Kievin dhe pastaj udhëtoi për në Moskë dhe Pekin, para se të merrte pjesë në samitin e NATO-s në Uashington.

"Misioni i paqes" i deklaruar nga vetë ai mori kritika të mëdha nga disa liderë të BE-së të cilët e distancuan bllokun nga veprimet e tij.





EMISARI SPECIAL I BE-SË, MIROSLAV LAJÇAK, KA TAKUAR TË PREMTEN NË PRISHTINË ZËVENDËSKRYEMINISTRIN BESNIK BİSLIMI

## Lajçaku: Ura duhet të hapet, por në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë

I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë të premtën në Prishtinë, pas takimit me kryenegociatorin e Kosovës për dialog, Besnik Bislimi, se ura mbi lumin Ibër duhet të hapet, mirëpo në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë të Kosovës. Lajçaku u ka thënë gazetarëve se është arritur pajtim për një raund të ri të dialogut në nivel kryenegociatorësh, por nuk ka treguar ndonjë datë për mbajtjen e këtij takimi. Ndërkaq zëvendëskryeministri Bislimi ka ritheksuar se hapja e urës kryesore të Mitrovicës mbi Ibër është trajtuar në Bruksel dhe se ajo duhet të hapet

llogaridhënie për shkeljet e vazhdueshme prej saj.

Pas takimit, Lajçaku u ka thënë gazetarëve se është arritur pajtim për një raund të ri të dialogut në nivel kryenegociatorësh, por nuk ka treguar ndonjë datë për mbajtjen e këtij takimi. Lajçaku ka bërë me dije se me Bislimin ka diskutuar për një sërë çështjesh, përfshirë hapjen e urës mbi lumin Ibër për qarkullim të automjeteve. Ai ka thënë se ura duhet të hapet, por hapja e saj duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë të Kosovës. "Ne, po ashtu, diskutuam për Urën e Mitrovicës dhe hapjen e saj për qarkullim të automjeteve. Besoj se qëndrimi i BE-së është i njohur, por do ta përsëris: ura duhet të hapet, por hapja e saj duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë të Kosovës dhe ne diskutuam për detajet e kësaj", ka deklaruar Lajçaku.

I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, tha se Serbia ka tërhequr letrën dërguar bllokut vitin e kaluar, ku shprehte rezerva për Marrëveshjen në rrugën drejt normalizimit të raporteve. Kryeministria e atëhershme e Serbisë, Ana Bërnabiq, dhjetorin e vitit të kaluar i dërgoi BE-së një letër, përmes së cilës Serbia shprehu rezerva për Marrëveshjen në rrugën drejt

normalizimit të raporteve të arritur në Bruksel, dhe Aneksin për Zbatim, të arritur në Ohër. Në atë letër u tha, mes të tjerash, se marrëveshja është e pranueshme vetëm në një kontekst që nuk i referohet njohjes de facto dhe de jure të Kosovës.

Pas takimit me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Besnik Bislimi në Prishtinë, Lajçaku tha se letra është tërhequr dhe marrëveshja është ende e vlefshme. Ai tha se kohë pas kohe ka deklarata që nuk ndihmojnë në zbatimin e marrëveshjeve. "Jo, Marrëveshja e Ohrit është ligjrisht e obligueshme dhe po punojmë për zbatimin e saj. Asnjëra palë nuk është tërhequr nga kjo marrëveshje dhe po diskutojmë me Kosovën dhe Serbinë se si ta përshpejtojmë zbatimin", ka pohuar Lajçaku. Marrëveshja prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut. Bashkimi Evropian së fundi ka përsëritur thirrjet ndaj autoriteteve të Kosovës që të përmbahen nga hapat e njëanshëm dhe të pakoordinuar që, sipas BE-së, mund të rrisin tensionet në veriun e banuar me

shumicë serbe.

BE-ja, por edhe Shtetet e Bashkuara, Franca, Britania dhe Gjermania, kanë kritikuar Kosovën për, siç kanë thënë, veprimet e njëanshme dhe të pakoordinuara, në veriun e banuar me shumicë serbe. Këto kritika janë bërë pasi më 30 gusht, Kosova mbylli pesë institucione që funksiononin sipas sistemit serb.

Sipas zyrtarëve shtetërorë në Kosovë, ato institucione kanë shkelur kushtetutshmërinë dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Institucionet e mbyllura më 30 gusht ishin: Qarku i Mitrovicës së Kosovës, Komuna paralele e Mitrovicës, Komuna paralele e Zveçanit, Komuna paralele e Zubin Potokut dhe Komuna paralele e Leposaviqit.

Në Kosovë ka komuna, kompani dhe ndërmarrje publike, çerdhe, shkolla fillore, të mesme dhe universitete publike që financohen drejtpërdrejt nga Qeveria e Serbisë, të cilat gjenden në qytetet dhe vendbanimet ku jeton komuniteti serb.

Këto institucione, sipas ligjeve në Kosovë, janë ilegale.

Më 2013 Kosova dhe Serbia, në dialogun për normalizimin e raporteve në Bruksel, kishin arritur një marrëveshje për shuarjen e institucioneve paralele, por ende kjo marrëveshje nuk është zbatuar plotësisht.

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur të premtën në takim emisarin special të BE-së, Miroslav Lajçak.

Diskutimet përgjatë takimit u përqendruan në tri tema kryesore: dakordimin dhe përgatitjet për takimin e radhës në nivel të kryenegociatorëve, zhvillimet rreth hapjes së urës kryesore të Mitrovicës mbi lumin Ibër dhe rruga përpara me planin e sekuencimit të zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe Aneksit të Zbatimit.

Zëvendëskryeministri Bislimi gjatë takimit ka theksuar se hapja

e urës kryesore të Mitrovicës mbi Ibër është trajtuar në Bruksel në kuadër të procesit të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe se ajo duhet të hapet sipas marrëveshjes ekzistuese dhe konkluzioneve të raportit të Komisionit Evropian të vitit 2020, që vlerëson se punimet në urë kanë përfunduar dhe ajo duhet të hapet pa vonesa dhe pa pengesa të mëtejme.

Ai nënvizoi se Qeveria e Republikës së Kosovës në vazhdimësi është angazhuar si palë konstruktive në dialog. Si e tillë ajo mbetet e përkushtuar për zbatim të plotë e të pakushtëzuar të Marrëveshjes Bazike dhe Aneksit dhe e bindur që nënshkrimi i saj është garanci e duhur dhe e nevojshme për zbatimin e plotë nga Serbia dhe

# Ministri i Punëve të Jashtme i Turqisë thotë se do ta mbështesin FSK-në për pajisje ushtarake

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Ministri i Punëve të Jashtme i Turqisë, Hakan Fidan, gjatë vizitës së tij të premtën në Prishtinë, ka thënë se shteti i tij do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në të gjitha fushat. Ai në një konferencë për medie me ministrin e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla, ka bërë me dije se Ankaraja po përgatitet që të nënshkruajë një marrëveshje në fushën e sigurisë me Prishtinën, por nuk ka dhënë më shumë hollësi për të.

Duke folur për paqen dhe stabilitetin në rajon, kryediplomati turk ka thënë se Turqia e mbështet dialogun për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. "Ne besojmë që problemet e Kosovës dhe të Serbisë mund të zgjidhen vetëm me dialog. Ne mbështesim përpjekjet për arritjen e normalizimit mes dy vendeve. Procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë është shumë i rëndësishëm në këtë kontest. Nëse vjen ndonjë kërkesë, ne si Turqi nuk do të hezitohet të marrim përgjegjësi në këtë drejtim", ka thënë ai.

Kryediplomati turk tha se Turqia dëshiron që këmbimet tregtare të rriten në 1 miliard euro, teksa tha se deri më tani kompanitë turke kanë investuar 500 milionë euro në Kosovë dhe kanë krijuar 10 000 vende pune. Ai, po ashtu, premtoi se shteti i tij do ta vazhdojë mbështetjen në



trajnimet, por edhe në ofrimin e pajisjeve ushtarake për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ministri i Punëve të Jashtme i Turqisë, Hakan Fidan, ka bërë me dije se me homologen Donika Gërvalla kanë biseduar për hapat që duhet të ndërmerren kundër lëvizjes Hizmet të klerikut Fetullah Gulen, që Turqia i referohet me akronimin FETO dhe të njëjtën e ka shpallur organizatë terroriste.

Fidan pretendoi se kjo organizatë paraqet kërcënim edhe për

Kosovën. "Folëm edhe për luftimin e terrorizmit, për hapat që duhet të ndërmerren kundër organizatës terroriste FETO [Organizata Terroriste Fethullaiste]. Për fat të keq, prania e FETO-s në Kosovë vazhdon të jetë shqetësuese për ne. Dua t'ju kujtoj se FETO është kërcënim edhe për Kosovën. Ne duhet ta luftojmë bashkërisht këtë organizatë", ka theksuar Fidan.

Në mars të vitit 2018, Kosova arrestoi dhe dëboi gjashtë shtetas

turq, që kishin punuar në shkollën private "Mehmet Akif" në Prishtinë.

Ndërkaq, ministrja e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, ka thënë se siguria dhe stabiliteti rajonal ishin ndër temat kyçe të takimit të saj me ministrin Fidan. Ajo ka thënë se roli i Turqisë, por edhe i NATO-s është i rëndësishëm për garantimin e paqes dhe stabilitetit rajonal, teksa akuzoi Serbinë fqinje për veprime destabilizuese. "Kosova mbetet e përkushtuar për

partneritetin me NATO-n dhe përforcimin e pranisë së saj në vendin tonë si një garanci për mbrojtjen e paqes në rajon. Në këtë kontekst, ne e shohim Serbinë si një kërcënim real për stabilitetin rajonal. Kërcënimet për bllokimin sot të pikave kufitare janë vetëm një dëshmi e shtuar e synimeve hegjemoniste, por edhe e veprimeve konkrete provokuese dhe destabilizuese të Serbisë të cilat shkojnë përtej kërcënimeve verbale", ka thënë Gërvalla.

## Serbia konfirmon kërkimet në një varrezë të mundshme masive pranë Novi Pazarit

PRISHTINË, 6 SHTATOR - "Besoj se nga mesi i shtatorit duhet të kemi një datë për fillimin e gërmimit apo vlerësimit të lokacionit", thotë Kushtrim Gara nga Komisioni Qeveritar i Kosovës për Persona të Zhdukur. Deponia e plehrave afër fshatit Kozhle në jugperëndim të Serbisë është një nga lokacionet që, sipas autoriteteve të Kosovës, mund të jenë fshehur krimet e kryera nga forcat serbe kundër civilëve shqiptarë në Kosovë gjatë luftës së viteve 1998/99.

Komisioni për të Pagjeturit i Qeverisë së Serbisë konfirmon për "Radion Evropa e Lirë" se kanë filluar përgatitjet për pastrimin e vendit dhe ndërtimin e një rruge hyrëse, pas së cilës gjë është planifikuar kërkimi i deponisë "Gollo Bërdo".

Gërmimet do të kryhen me kërkesë të Kosovës, e cila e ka



informuar palën serbe për mundësinë që në këtë vend të jenë varrosur eshtra të civilëve të vrarë shqiptarë, të cilët figurojnë të zhdukur për më shumë se dy dekada.

Gara thotë se informacionet për këtë lokacion janë siguruar nga dëshmitarë të ndryshëm dhe se përgatitjet në terren kanë filluar më 26 gusht.

Ai tha se shpreson se përgatitja

për gërmime afër Novi Pazarit "nuk është një përpjekje e re e Serbisë për t'i shmangur lokacionet e tjera të shënuara". Këtë lokacion, në fund të gushtit, e vizituan edhe për përfaqësues

të misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë, EULEX, bashkë me zyrtarë nga Kosova dhe nga Serbia. "Ky aktivitet është zhvilluar në përputhje me përkushtimin e EULEX-it për t'i mbështetur institucionet përkatëse - duke u ofruar ndihmën e ekspertëve të mjekësisë ligjore - për zbardhjen e fatit të më shumë se 1 600 personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë", thuhet në një deklaratë të EULEX-it dhënë "Radios Evropa e Lirë".

Gjatë luftës së viteve 1998 dhe 1999 në Kosovë u vranë më shumë se 13 000 civilë, kryesisht shqiptarë, ndërsa mijëra të tjerë u zhdukën.

Në territorin e Serbisë, që nga fillimi i viteve 2000, janë zbuluar pesë varreza masive me gati një mijë trupa.

Sipas Kryqit të Kuq, në Kosovë janë ende 1 612 persona të pagjetur nga lufta.

## Hamza dhuron gjak në QKMF-në e Mitrovicës

MITROVICË, 6 SHTATOR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, së bashku me nënkryetarin Arian Tahiri dhe drejtorin për Shëndetësi, Fahri Shabani, kanë dhënë vullnetarisht gjak në Qendrën e Mjekësisë

Familjare “Dr. Nexhat Çuni” në Mitrovicë. Me këtë rast, kryetari Hamza tha se shumë jetë varen nga dhurimi vullnetar i gjakut dhe është përgjegjësi e jona që të solidarizohemi me njerëzit që kanë nevojë. Ndërsa nënkryetari Tahiri

shtoi se ashtu siç thuhet edhe në mesazhin e Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut, “një pikë gjaku e dhuruar nga ju, për dikë do të thotë jetë”, andaj kushdo që gëzon shëndet të mirë, dhuroni gjak dhe shpëtoni jetë.



## Ndalohe dy persona për falsifikim të dokumenteve në Ferizaj

FERIZAJ, 6 SHTATOR - Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda, ka njoftuar se me vendim të Prokurorit të Shtetit, ka ndaluar për 48 orë të dyshuarin R. O., person zyrtar, në zyrën e gjendjes civile në komunën e Ferizajt, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer

veprën penale “Falsifikim i dokumentit zyrtar” nga neni 427 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Po ashtu, lidhur me këtë rast është ndaluar edhe personi tjetër i dyshuar me initiale F. V., në kohëzgjatje prej 48-orësh, i cili dyshohet se ka kryer veprën penale “Falsifikim i

dokumente” nga neni 390 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka njoftuar se ndaj të dyshuarit R. O. brenda afatit ligjor do të paraqesë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në gjykatën kompetente.



## Kryetari Latifi: Policia ka nevojë për mbështetje të vazhdueshme nga qeveria



Rahovec, 6 shtator - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, me rastin e 25-vjetorit të themelimit të Policisë së Kosovës ka vizituar stacionin e policisë në këtë komunë. Ai ka

thënë se në 25-vjetorin e Policisë së Kosovës “nderojmë policët e rënë në detyrë dhe të gjithë ata që shërbejnë për sigurinë e vendit tonë”. “Policia e Kosovës është

krenare për profesionalizmin e ndërtuar që nga themelimi, duke u bërë faktor sigurie dhe stabiliteti kudo në Kosovë. Ajo ka nevojë për mbështetje të vazhdueshme nga

qeveria dhe për bashkëpunim më të madh për ta përmbushur misionin e saj për sigurinë e qytetarëve. Mirënjohje për kontributin e policisë dhe lavdi

përjetë për ata që ranë në detyrë. Urime të përzemërta të gjithë zyrtarëve policorë, kapitenin Fazli Morina dhe ekipin e tij në Rahovec”, ka thënë kryetari Latifi.

## Bresalci, Cërrnica dhe Mireshi po bëhen me laboratorë për analiza biokimike

Gjilan, 6 shtator - Sektori shëndetësor në komunën e Gjilanit vazhdon të shënojë përparim të prekshëm për pacientët. Tanimë edhe në ambulancat e fshatrave po bëhen transformime rrënjësore dhe decentralizim të

shërbimeve mjekësore. Me laboratorë për analiza biokimike për AMF, po bëhen edhe ambulancat në Bresalc, Cërrnicë dhe Miresh. Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka nënshkruar memorandum

për laboratorët e tri AMF-ve në këto fshatra me drejtorin e organizatës Qatar Charity, Esam Dabab. “Decentralizim i shërbimeve, ulje e kostos për qytetarët dhe rritje e cilësisë”, tha kryetari Hyseni.



# Faktorët që po i kontribuojnë dhunës me armë zjarri dhe si parandalohet ajo



Në Kosovë së voni janë regjistruar disa raste të dhunës me armë zjarri, që kanë çuar edhe në vrasje. Njohësit e çështjeve të sigurisë kërkojnë që shteti të bëjë më shumë sa i përket konfiskimit të armëve ilegale, pasi argumentojnë se ato mund të gjenden lehtë në tregun e zi. Ata, po ashtu, kërkojnë rritjen e operacioneve policore për ta ulur numrin e incidenteve të armatosura

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Numri i lartë i armëve ilegale dhe mosprioritizimi i sigurisë publike nga institucionet po kontribuojnë, sipas njohësve të fushës së sigurisë, që në Kosovë të ndodhin raste të dhunës me armë zjarri. Ditët e fundit në vend ka pasur vrasje, por edhe incidente të tjera me armë zjarri, që kanë sjellë në vëmendje gjendjen e sigurisë publike. Më 1 shtator dy grupe të armatosura u përleshën në një lagje të Prishtinës. Autoritetet thanë se mosmarrëveshjet e mëhershme mes dy grupeve të armatosura ishin shkak i kësaj përleshjeje që la të vrrarë një person. Profesori i Kriminalistikës në Kolegjin AAB, Fatmir Çollaku, thotë për Radion Evropa e Lirë se qërimi i hesapeve mes grupeve kriminale dhe me të kaluar kriminale “është një dukuri e rëndomtë në botën moderne”.

Udhëheqësi i hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), Ramadan Ilazi, thotë për REL-in se janë dy faktorë që po krijojnë cenueshmëri ndaj dhunës me armë të vogla. I pari, sipas tij, është prania e një numri të madh të armëve të vogla të zjarrit, të cilat “janë lehtë të qasshme për njerëzit në tregun e zi”. Me këtë pajtohet edhe Çollaku. “I dyti: viteve të fundit siguria publike nuk duket që ka qenë prioritet për shkak se shumica e vëmendjes dhe kohës është investuar në pjesën veriore të Kosovës, me sa duket”, shprehet Ilazi. Nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) i kanë thënë më herët Radios Evropa e Lirë se mbi 230 000 armë pa leje llogaritet të jenë në duart e qytetarëve të Kosovës. Ndonëse Policia e Kosovës nuk ka dhënë një numër të

përgjithshëm të rasteve të dhunës me armë zjarri, raportet e përditshme të saj kanë treguar se vetëm në gusht kanë ndodhur më shumë se 50 raste të përdorimit të armëve të zjarrit, ndërsa pesë të tjera gjatë tri ditëve të para të shtatorit.

As MPB-ja e as Policia nuk u janë përgjigjur pyetjeve të REL-it se çfarë hapash konkretë po ndërmerren që rastet e dhunës me armë zjarri të mos rriten. Megjithatë, në Strategjinë e Sigurisë të Kosovës 2022-2027 potencohet se ruajtja e rendit publik dhe kushtetues është “interes jetik shtetëror që do të zbatohet në gjithë territorin e shtetit”.

Ndërkaq, Policia, në raportin e saj vjetor për vitin 2023, ka thënë se ndërmerr fushata për vetëdijesimin e qytetarëve për rreziqet e sigurisë dhe se organizon fushata kundër përdorimit të armëve të zjarrit.

## Problemi i armëve ilegale

Si Çollaku ashtu edhe Ilazi theksin e vënë tek armët ilegale, që ata thonë se me lehtësi gjenden në tregun e zi të Kosovës. “Shteti i Kosovës duhet të bëjë më tepër përmes aktiviteteve preventive, operacioneve të ndryshme policore, në kuptimin e kontrollit kriminalistik, që praktikisht

nënkupton identifikimin e armëve ilegale, që do të pasonte me konfiskimin e tyre, e që do të çonte me një zvogëlim të numrit të tërësishëm të armëve pa leje, sidomos në duart e qytetarëve”, thotë Çollaku.

Sipas të dhënave që Policia ia dërgoi REL-it, nga janari deri në korrikun e vitit 2024 janë konfiskuar 714 armë të ndryshme, ndërkaq në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishin konfiskuar 636 armë.

Çollaku dhe Ilazi kërkojnë realizimin e fushatave vetëdijesuese, por edhe inicimin e një fushate që do të ofronte një lloj amnistie për qytetarët që dorëzojnë armët ilegale.

Një nismë për dorëzimin e armëve të zjarrit ishte praktikuar menjëherë pas luftës, por edhe në vitet pasuese kishte pasur fushata për legalizimin e armëve. Hulumtuesja e Institutit Flaman për Paqe me bazë në Bruksel, Astrid De Schutter, puna e së cilës fokusohet në çështjen e dhunës me armë zjarri, thotë për REL-in se disa shtete të Ballkanit përballen me nivele të larta të vrasjeve nga incidentet e dhunshme me armë. “Ato ende përballen me praninë e armëve nga luftërat e viteve '90 në ish-Jugosllavi”, shprehet ajo.

De Schutter thotë se shtetet mund të ndërmarrin një sërë

hapash për të parandaluar dhunën me armë zjarri.

I pari, sipas saj, është puna në aspektin ligjor dhe edhe në krijimin e mekanizmeve të kontrollit për armët. “Në mënyrë që të zbatohen ligjet për armët, dhe të hetohen dhe të ndiqen penalisht krimet që lidhen me armët, shtetet duhet të investojnë në kapacitete operacionale”, thekson ajo.

Kosova ka ligje që përcaktojnë se kush dhe nën çfarë kushtesh mund të pajiset me armë zjarri. Po ashtu, ligjet parashohin dënime me gjoba dhe me burgim për poseduesit e armëve pa leje.

Ilazi thotë se në mënyrë që institucionet të vendosin si prioritet sigurinë publike, së pari duhet ta pranojnë se dhuna me armë zjarri është problem.

Më pas, sipas tij, do të duhej të vazhdohej me hapa të tjerë, siç janë rritja e operacioneve të konfiskimit, e patrullave policore, por edhe luftimi i tregjeve ilegale të armëve, në bashkëpunim me vendet e rajonit.

Policia e Kosovës ka njoftuar vitin e kaluar se ka mbyllur 23 rrugë ilegale për kontrabandën e armëve dhe të mallrave në kufirin Kosovë-Serbi, dhe gjashtë rrugë të tjera në kufirin me Malin e Zi, në bashkëpunim me autoritetet malazeze.

## Nis vjelja e rrushit me moton "Për kokërr të qejfit"

**RAHOVEC, 6 SHTATOR** - Të premten në Rahovec ka filluar Festivali i Vjeljes së Rrushit "Hardh Fest" me moton "Për kokërr të qejfit". Edhe ky vit do të festohet me traditën e përpunimit të rrushit me aktivitete të shumta, me muzikë, me degustim verërash dhe me shumë surpriza të tjera deri më 8 shtator. Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, së bashku me kryetarin e

komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, dhe zyrtarë të tjerë, kanë bërë prerjen ceremoniale të kalaveshit të rrushit në kuadër të këtij festivali. Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka ftuar qytetarët e Kosovës, bashkëkombësit tanë kudo që janë e shtetasit e huaj, të mos e humbasin rastin, të vijnë dhe ta përjetojnë Festivalin e Vjeljes së Rrushit.

Për këto tri ditë qytetarët do ta kenë rastin t'i shijojnë verërat autentike lokale nga kantinat më të njohura, gjithashtu do të ketë muzikë live dhe performanca artistike. Po ashtu, do të ketë gara dhe aktivitete për të gjitha grupmoshat. Në kuadër të këtij festivali vizitorët do të mund t'i zbulojnë traditat e lashta dhe mënyrat e përpunimit të rrushit.



## Çmimet e konsumit shkuan në 1,4 % vjetore dhe 0,2 % mujore

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin gusht, viti bazë 2015=100. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,4 % në muajin gusht 2024, krahasuar me muajin gusht 2023. Inflacioni mujor ishte 0,2% në muajin gusht 2024. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,4 % në muajin gusht 2024 krahasuar me muajin gusht 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: biletat e fluturimeve

(26,3 %), kafa, çaji dhe kakao (8,9 %), pushime të organizuara (7,5 %), peshqit (6,3 %), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (6,2 %), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (5,6 %), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (4,9 %), veshje (4,5 %), pijet alkoolike (4,3 %), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (3,7 %), shërbimet financiare (3,7 %), kujdesi personal (3,6 %), gazetatat, librat dhe materialet për zyra (3,2 %), buka dhe drithërat (3,2 %), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (3 %), duhani (2,8 %), mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit (2,4 %), pemët (2,3 %), prodhimet ushqimore (2,1 %), mish (2 %), gjërat dhe pajisjet e



tjera rekreative, kopshtet dhe manaret (1,2 %), shërbimet hoteliere (1 %), qumështi, djathi dhe vezët (0,7 %) dhe energjia elektrike (0,7 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve

prej 2,2 për qind në IHÇK. Rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: perimet (-7,6 %), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-5,3 %) dhe blerja e automjeteve (-

3,2 %), me një ndikim prej -0,8-përqindësh në IHÇK. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,2 % në muajin gusht 2024 krahasuar me muajin korrik 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: biletat e fluturimeve (12,2 %), perimet (2,1 %), qumështi, djathi dhe vezët (0,7 %), mish (0,5 %) dhe buka dhe drithërat (0,2 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,4-përqindësh në IHÇK. Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-2,3 %) me një ndikim prej -0,2-përqindësh në IHÇK.

## Greçia e interesuar për bashkëpunim në fushën e TIK-ut me Kosovën

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka pritur në një takim zëvendësministrin e Punëve të Jashtme të Greçisë, njëkohësisht përgjegjës për diplomacinë ekonomike greke, Kostas Fragogiannis, i cili po viziton Kosovën në sajë të Forumit Ekonomik Kosovë - Greçi. Gjatë takimit ministria Rizvanolli ndau të arriturat në fushën sektorit të teknologjisë informativë dhe komunikuese ku potencoi se që nga viti 2022 avancimi vjetor në fushën e TIK-ut ka qenë 13 %, kurse arritur pothuajse të dyfishohet në vitin



2023 në 25 %. Në sajë të kësaj rritjeje, nga sektori i TIK-ut kanë arritur të punësohen rreth 10 mijë persona

si dhe 70 % e kompanive të sektorit eksportojnë shërbimet e tyre. Gjithashtu, ajo e njoftoi

zëvendësministrin grek për të arriturat në fushën e BRE-ve siç ishte suksesi i ankandit të parë solar 100 MW si dhe ankandet e tjera të radhës që janë pjesë e pakos investuese ku Ministria e Ekonomisë synon të ndërtojë 950 MW kapacitete të reja të energjisë së ripërtëritshme me një investim total 1.2 miliard euro. Projekti i ardhshëm, i cili pritet të zhvillohet, është procedura konkurruese për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë nga era me 150 MW me përkrahje të USAID dhe IFC si këshilltar transaksioni, proces ky i cili pritet të marrë formën së

shpejti. Greçia është një nga shembujt e mirë në prodhimin e energjisë ku kompanitë kanë ekspertizën dhe përvojën e duhur pasi që rreth 65 % e energjisë së prodhuar është e pastër. Andaj, ministria Rizvanolli kërkoi nga zëvendësministri Fragogiannis që të ftojë kompanitë greke për të investuar në fushën e energjisë në Kosovë. Zëvendësministri grek shprehu interesimin e Greçisë për bashkëpunim kryesisht në zhvillimin e infrastrukturës së TIK-ut dhe Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE).

## ATK-ja rrit të hyrat për 62.9 milionë euro në raport me vitin e kaluar

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se të hyrat tatimore për periudhën janar-gusht 2024 kanë shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. "Të hyrat tatimore për periudhën janar - gusht 2024 kanë shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me

të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Të hyrat për këtë periudhë janë rritur për 62.9 milionë euro, duke reflektuar pozitivisht në përpjekjet e vazhdueshme për përmirësimin e performancës dhe zbatimin e reformave strategjike", ka njoftuar ATK-ja. Sipas këtij njoftimi, totali i të hyrave të inkasuara ka arritur në 642.0 milionë euro tative,

duke shënuar kështu rritje të qëndrueshme për buxhetin e shtetit. "Kjo rritje lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e reformave të rëndësishme që kanë për qëllim përmirësimin e efektivitetit dhe rritjen e transparencës", është theksuar në njoftimin e ATK-së. Më tutje thuhet se ndikimi i reformave të ndërmara përfshin digjitalizimin e

proceseve të punës, trajtimin e borxheve tatimore, krijimin e kanaleve për raportim të rasteve korruptive, luftimin e evazionit tatimor, rritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënia janë disa nga reformat të cilat kanë ndihmuar në ngritjen e performancës. ATK-ja ka njoftuar se mbetet e përkushtuar për forcimin e përmirësimit dhe



përmirësimin e vazhdueshëm të mbledhjes së të hyrave dhe zvogëlimin e hendekut tatimor duke u siguruar paguajnë saktë detyrimet tatimore.



# Rezistenca e fundit e përgjakshme gjermane në Itali



Nga: Simon HEFFER /  
The Daily Telegraph  
Përkthimi: Telegrafi.com


Gjatë pesë muajve përpara Ditës-D, fuqitë aleate u përqendruan në Itali dhe në betejën për të marrë Romën. Që nga vera e kaluar, Mussolini ishte diktator marionetë; penjtë e tij tërhiqeshin nga miqtë e tij në Berlin, duke sunduar në një pjesë të madhe të vendit, madhësia e të cilit u zvogëluar në mënyrë të vazhdueshme pas përmbyesjes së tij. Objektivi i aleatëve ishte ta nxirrnin jashtë loje. Rëndësia simbolike e marrjes së kryeqytetit të Italisë ishte thelbësore për këtë qëllim: kjo, në muajt e parë të vitit 1944, nënkuptonte shpeshherë luftën në kushte të tmerrshme dhe në terrene të vështira dhe malore. Kazino 1944 [Cassino '44] është historia e asaj lufte dhe se si një ushtri fanatike e gjermanëve u masakrua në përpjekjen e tyre të pafytyrshme për të fituar. James Holland, i ndihmuar nga ekipi të cilin e falënderon, ka bërë një punë të jashtëzakonshme

kërkimore dhe përkthimi në përgatitjen e këtij libri. Detajet janë mahnitëse. Holland ka studiuar burimet parësore dhe dytësore nga pjesëmarrësit në të dy anët e betejës, si dhe nga italianët e pafat të zënë në mes: veçanërisht të burgosurit e abacisë në Monte Kazino, ku gjermanët i përdorën si murgjit ashtu edhe vendasit – të cilët u strehuan atje – si mburoja njerëzore. Ai bazohet në letrat dhe ditarët e trupave britanike, amerikane, polake, franceze dhe të Komonuelthit britanik; si dhe dosjet e gjermanëve të cilët përfundimisht u mundën, e të cilat ilustrojnë jo vetëm kotësinë e rezistencës së tyre, por edhe trimërinë e tyre. Libri është i mbushur me ilustrime të dhunës, por kështu mbase duhet të jetë: zorrët e derdhura, gjymtyrët e prera, kokët e këputura dhe tmerret e tjera ishin përvoja e përditshme e atyre që kishin fatin të mbijetojnë. Ka emra të njohur nga historitë e tjera ushtarake – Montgomery i El-Alameinit shfaqet shkurtimisht me Ushtrinë e tij të

Tetë përpara se të kthehej përsëri në Angli për të udhëhequr pjesën britanike në Operacionin Overlord – për pushtimin e Normandisë më 6 qershor. Por, Holland gjithashtu ndjek pushkatarin Audie Murphy, i cili jo më pak për shkak të heroizmave të tij të famshëm gjatë luftës, bëri karrierë të mirë si aktor hollywoodian; ka po ashtu një paraqitje të shkurtër të pushkatarit Terry Milligan, i njohur më mirë si Spike [komedian, dramaturg, muzikant i njohur më vonë]; dhe, ka përkujtes se në luftë tmerret nuk kryhen gjithmonë nga armiqtë tuaj. Holland detajon epideminë e përdhunimit dhe plaçkitjes së grave të varfra italiane nga gumierët – ushtarët marokenë që luftonin për kauzën aleate: tani e dimë se ishte paralajmërim i sjelljes së neveritshme të Ushtrisë së Kuqe ndaj grave gjermane në vitet 1944-'45. Holland përshkruan vlerat strategjike të fushatës italiane: ajo i devijoi trupat gjermane dhe fuqinë ajrore nga ajo që do të bëhej teatri kryesor i operacionit

në Normandi dhe ishte vendimtar për dobësimin e aviacionit gjerman – gjë që ndihmoi që invadimi në Francë të ketë sukses. Me gjermanët të cilët deri në qershor 1944 ishin të mundur dhe ndiqeshin në veri të Romës, batica tashmë ishte kthyer kundër tyre në Frontin Lindor, ndërsa luftimet në Francë dëshmuar se sa mund të arrinin. Ajo që ndodhi në Itali ishte vendimtare për suksesin e kësaj fushate. Fakti që iu deshë shumë kohë aleatëve, pas zbarkimeve relativisht të drejtpërdrejta në Anzio, për të bërë përparim në veri dhe në lindje, ishte jo vetëm për shkak të udhëheqjes të dobët. Holland çmon mendimtarin Harold Alexander, gjeneralin e lartë britanik, dhe kërkon në mënyrë eksplicite të rindërtojë reputacionin e Mark Clarkut, komandantit amerikan. Të tjerët dalin jo aq mirë në oborrin e historisë dhe fajësohen për gabimet taktike që vonuan çlirimin përfundimtar të Romës: veçanërisht krahu i djathtë i Clarkut, gjenerali John Lucas, i cili

përfundimisht u hoq nga posti i tij për humbjen e mundësive të ndryshme për të avancuar (dhe ai ishte më i lumtur në postin e ri si komandues në bregdet dhe jo në front). Problemi i Alexanderit ishte gjenerali Bernard Freyburg, shumë i guximshëm (e fitoi Kryqin e Viktorias në Luftën e Parë Botërore dhe kishte tri dekorata të tjera), por thjesht nuk ishte inteligjent. Rrëmuja që ai i bëri Monte Kazino shpjegohet në detaje, si dhe paafësia e tij për të kuptuar atë që njëri nga vartësit e tij shumë më të zgjuar, gjenerali Francis Taker, ia shpjegonte atij (me saktësi) për të marrë majën e malit. Ashtu si në shumicën e luftërave, politika e zyrës luajti rol në të dyja palët: gjermanët u dërrmuar nga bindja fanatike se komandanti i tyre, Kesselring, kishte ide të ndryshme të çmendura që drejtoheshin nga Hitleri. Kazino 1944 është libër i plotë dhe i hulumtuar në mënyrë të përpiktë dhe duhet të jetë standard në këtë aspekt. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Kosova pëson humbje të thellë nga Rumania



## “Epoka e re”

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Kosova ka pësuar humbje në ndeshjen hapëse të edicionit të ri të Ligës së Kombeve. Në përballjen e parë të Grupit 2 në Ligën C, Dardanët u mposhtën nga Rumania, me rezultat të thellë 3:0. Ndeshja, e zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë, të premtën mbrëma, nisi me dinamizëm nga futbollistët dardanë dhe përkrahje të madhe nga tifozët e pranishëm. Kosova shfaqti disa momente premtuese gjatë pjesës së parë, por Rumania arriti të amortizojë aksionet e ekipit tonë, teksa në minutën e 40-të shënoi gol, përmes Dennis Man. Ky moment ndikoi në

ecurinë e mëtejme të lojës, me rumunët që arritën të menaxhojnë epërsinë deri në fund të pjesës së parë. Edhe pjesa e dytë nisi keq për Kosovën, pasi në minutën e 51-të, Rumania realizoi golin e dytë pas një penalltie të akorduar me ndërhyrjen e VAR-it, e të cilën e shndërroi në gol Razvan Marin. Pas këtij goli, Kosova vazhdoi të luftojë në kërkim të golit të kthesës, por rumunët ruajtën qetësinë dhe kontrollin e lojës. Madje, në minutën e 82-të mysafirët realizuan edhe golin e tretë përmes Denis Dragush. Kosova e mbylli ndeshjen me 10 lojtarë, pasi pak para përfundimit të takimit u përjashtua Mërgim Vojvoda. Ndeshjen e radhës, Kosova e zhvillon më 9 shtator si mysafirë e Qipros.

## Italia e fortë për Francën, fiton edhe Belgjika

Italia e ka nisur me fitore të madhe sezonin e ri në Ligën e Kombeve, pasi triumfuan 3-1 në udhëtim te Franca. Pas vetëm një minute lojë, Gjelat kaluan në epërsi me golin e Bradley Barcolas. Por, Azzurët nuk u dëshpëruan dhe filluan spektaklin e tyre. Federico Dimarco u asistua prej Sandro Tonalit, për t'i barazuar shifrat në 1-1 në minutën e 30-të. Mario Retegui asistoi te Davide Frattesi në minutën e 51-të, që përmbysi shifrat në 2-1. Për të volorur fitoren e Belgjikës u përkujdes Giacomo Raspadori (74'), me një asistim të Udogie për 3-1. Fitore po aq të thellë shënoi edhe Belgjika, që mposhti Izraelin, ku ndajnë kreun me italianët në Grupin A, përkatësisht Grupi 2.

## SHKURT

### Xhaka akuzon danezët për lojë të pistë

Mesfushori Granit Xhaka u ndëshkua me karton të kuq në ndeshjen që Zvicra e humbi 2-0 nga Danimarka. Në fillim të pjesës së dytë me karton të kuq u ndëshkua edhe Nico Elvedi i Zvicrës. Pas ndeshjes kapiteni i zviceranëve, Xhaka, ka akuzuar kundërshtarët danezë për lojë të pistë. “Vitet e fundit jam shumë më i qetë, por kur një lojë është aq e padrejtë sa sot, emocionohem shumë. Në futboll fjala respekt në fakt shkruhet me shkronja të mëdha. Por, ajo që treguan sot lojtarët e Danimarkës nuk ka të bëjë me respektin”, ka thënë Xhaka.

### Prishtina demolon Besën në miqësore

Në stadiumin e 2 Korrikut, Prishtina triumfoi bindshëm me rezultatin 5:1 ndaj Besës së Pejës, skuadër e Ligës së Parë. “Bardhekaltrit” e nisën fuqishëm që në pjesën e parë, duke shënuar tri herë. Albin Krasniqi realizoi dy gola, me asistimin e Limanit për të parin, ndërsa Igbal Jashari shtoi një tjetër gol, me një pasim vendimtar nga N’Gatta. Në pjesën e dytë, Besa arriti ta ngushtonte rezultatin në 3:1, por Prishtina reagoi me dy gola të tjerë, të shënuar nga Kryeziu dhe Sobowale, i cili shënoi edhe golin përfundimtar për 5:1.

### Artim Pollozhani, trajner i Ballkanit

Kampioni i Kosovës në futboll, Ballkani, ia ka besuar Artim Pollozhanit pozitën e trajnerit në skuadër. 42-vjeçari që do ta udhëheqë Ballkanin në vazhdim të kampionatit ishte zëvendës i ish-trajnerit, Ilir Daja, me të cilin së fundmi i kishte raportet e acaruar, për çka edhe në muajin mars ishte larguar nga suharekasit. Për të është hera e parë që do të jetë në krye të shtabit teknik të një skuadre, pasi edhe te Partizani i Tiranës ka qenë në rol të asistentit. Ndonëse Klubi nga Suhareka nuk e ka zyrtarizuar ende, ish-reprezentuesi i Maqedonisë është parë në stadiumin e qytetit duke e udhëhequr stërvitjen e portokallzinjve. Për një kohë ai e ka mbajtur edhe pozitën e zëvendës drejtorit sportiv të “Xhebrailat” para se ta mbyllte etapën me ta. Ky rikthim i tij në Suharekë vjen pas ndarjes së rrugëve në mes të Ballkanit dhe Ilir Dajës. Me këtë të fundit, ish-futbollisti i Vardarit të Shkupit, Makedonija Gjorche Petrovit, Torpedos së Moskës, Shkëndijes e disa skuadrave të tjera, nuk i kishte raportet e mira para se të largohej.

## Makolli nderohet me çmimin ‘Ambasador i Paqes’

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Presidenti i Federatës së Kickboxit, Fatmir Makolli, është nderuar me çmimin “Ambasador i paqes” për kontributin e tij të dhënë në promovimin e sportit. Këtë çmim Makolli ia dorëzoi Tahir Shabani nga organizata “Global Socio-Economic and Financial Evolution Network” në Londër. Ai me këtë rast ka thënë se Makolli ka kontribuar shumë në promovimin e sportit të

Kosovës në arenën ndërkombëtare. “Është nder dhe krenari ta nderojmë presidentin e Federatës së Kickboxit, Fatmir Makolli, me titullin ‘Ambasador i paqes’. Është me të vërtetë kontribut. Promovimi i sporteve të Kosovës meriton përkrahje edhe ndërkombëtare për të gjitha medaljet e arta që Kosova na i solli”, ka thënë Tahiri. Kurse vetë Makolli u shpreh shumë i

lumtur me këtë çmim për të cilin tha se do të jetë një shtytje edhe më e madhe për të punuar me më shumë përkushtim për sportin e Kosovës. “Jam shumë i nderuar me këtë çmim dhe besoj është një stimulim i madh që në të ardhmen të punoj edhe më shumë për sportin sepse dihet që sportisti është ambasadori më i mirë i shtetit”, ka theksuar Makolli.



## Messi pas pensionimit të Di Marias nga kombëtarja: Do të na mungosh shumë

**BUENOS AIRES, 6 SHTATOR** - Angel Di Maria është përshëndetur me bashkëlojtarët tek Argjentina, pasi vendosi të pensionohet nga kombëtarja. Ish-futbollisti i shumë skuadrave të mëdha u nderua mbrëmë nga shokët e skuadrës, stafi dhe

tifozët, në ndeshjen që Argjentina e fitoi ndaj Kilit me rezultat 3-0 në kuadër të kualifikimeve për Kampionat Botëror të vitit 2026. Një letër emocionuese për lojtarin e Benficas e pati edhe kapiteni i kombëtares, Lionel Messi. Ylli argjentinasi i uroi gjitha të mirat për Di

Marian, ku theksoi se do t'i mungojë sulmuesi anësor. "Shpresoj ta shijoni shumë këtë mbrëmje me familjen dhe të dashurit tuaj. Ne kemi thënë gjithçka që duhej të thoshim. Kemi ndarë qaq shumë momente dhe kush do ta kishte menduar se do të

përfundonte në këtë mënyrë? Do të na mungosh shumë. Shihemi së shpejti", ka thënë Messi. Di Maria ka luajtur gjithsej 145 ndeshje me kombëtaren dhe ka realizuar 31 gola. Gjithashtu, ai ka fituar një Kupë të Botës dhe dy Copa America me kombëtaren e tij.



## Besa Famgas e Istogu, skuadrat dominuese në Superkupë

**RAHOVEC, 6 SHTATOR** - Në shkurtin e vitit të kaluar u vendos që për herë të parë të organizohet gara për Superkupën e Kosovës në hendboll. Për Superkupë tradicionalisht luajnë kampioni dhe fituesi i Kupës. Superkupa e Kosovës në hendboll për herë të parë u organizua në kuadër të shënimit të 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Te hendbollistët, Superkupën e parë e fitoi Besa Famgas që e mposhti Kastriotin e Ferizajt me rezultat 36:29. Te hendbollistët, Superkupa e parë i takoi Istogut. Skuadra istogase kishte fituar ndaj Ferizajt me rezultat 33:17. Ndeshjet e para të Superkupës ishin luajtur në Istog. Në shtator të vitit të kaluar Superkupa u organizua për herë të dytë në Mitrovicë. Kjo ndodhi pas vendimit që Superkupa të



zhvillohet në prag të edicionit të ri të garave. Besa Famgas sërish e fitoi Superkupën, duke mposhtur Trepçën me rezultat 36:28. Te hendbollistët, fitues ishte Istogu që mposhti Ferizajn me rezultat 31:27. Te hendbollistët, Superkupa do të ketë fitues tjetër. Të shtunën në Rahovec takohen Rahoveci dhe Kastrioti. Rahoveci është kampion, ndërsa Kastrioti

fitues i Kupës. Te hendbollistët sërish përballen Istogu dhe Ferizaj. Istogu është kampion, kurse Ferizaj fitues i Kupës. Ky edicion i Superkupës i kushtohet të ndjerit Izet Gjinovci, që për mbi dy dekada ishte sekretar i përgjithshëm i FHK-së. Gjinovci ndërroi jetë më 5 gusht, ndërsa ia kushtoi thujse gjithë jetën hendbollit.

## 900 gola në karrierë, Ronaldo: Një arritje unike

**LISBONË, 6 SHTATOR** - Një goditje fluturimthi, një gol shumë i bukur, por finalizime të tilla janë normale për një legjendë si Cristiano Ronaldo, vetëm shifrat e tij nuk janë normale. Ndaj Kroacisë, portugezi realizoi golin e tij të 900 në karrierë. Nuk kishte mënyrë më të bukur për të arritur këtë shifër sesa me fanellën e përfaqësueses portugeze. Kjo ishte një arsye e fortë për të bërë që ylli i futbollit botëror të festonte mes lotësh. Së bashku me të festuan edhe të gjithë tifozët, jo vetëm në stadium. Pavarësisht se 39-vjeçar dhe larg futbollit të rëndësishëm evropian, Ronaldo vijon ta bëjë liderin. Në përfundim të sfidës, CR7 foli për faqen zyrtare të UEFA-s ku nuk i fshehu emocionet për këtë arritje të madhe. "900 gola në karrierë do të thotë shumë për mua. Është një



numër që dëshiroja ta arrija prej kohësh. Unë e dija se këtë numër do ta arrija pasi nëse luan në vazhdimësi kjo do të vinte në mënyrë natyrale. Kjo ishte një ndeshje shumë e bukur nga të dy ekipet. Mendoj se ne e merituam fitoren, kishim më shumë raste, kishim më shumë kontrollin e topit", ka thënë Ronaldo. "Një

tjetër rekord tani? Rekordet vijnë në mënyrë natyrale. Unë jam i lumtur, pasi për mua ishte një pikë unike në karrierë, por gjëja më e rëndësishme është ta mbështes ekipin. Pas Evropianit ishte e rëndësishme të linim një shenjë të mirë përballë publikut tonë", u shpreh Ronaldo për faqen zyrtare të UEFA-s.

### SHKURT

#### Ter Stegen: Jam shumë i lumtur në Barcelonë

Portieri i Gjermanisë, Marc-Andre Ter Stegen, u ndal edhe në situatën e tij te Barcelona. Ai ka konfirmuar se është shumë i lumtur në skuadrën e Barcelonës. "Kam një kontratë relativisht të gjatë me klubin tim. Jam shumë i lumtur për këtë. Familja ime është shumë e lumtur në Katalonjë. Mezi po e prisnim fillimin e sezonit. Mendoj se është mirë për mua të fokusohem në të tashmen dhe të ardhmen e afërt. Askush nuk e di se çfarë do të ndodhë më pas. Në përgjithësi jam shumë i lumtur në këtë moment me situatën time. Dua ta ndihmoj sa më shumë klubin ku kam luajtur një dekadë", ka thënë Ter Stegen.

#### Djali i David Beckhamit lë futbollin për t'u bërë model

Ish-futbollisti i Brentfordit, Romeo, që ka baba legjendën e Anglisë, David Beckham, është pensionuar në moshën 22-vjeçare. Sipas "Sun Sport", Romeo ka vendosur të tërhiqet nga futbollit dhe të vazhdojë me modelim. 22-vjeçari kishte filluar të luante futboll te skuadra e Arsenalit. Më pas ai vazhdoi në Amerikë te Miami Akademi, për të luajtur disa ndeshje tek Inter Miami II dhe në Brentford. Romeo tashmë ka nënshkruar kontratë me disa kompani të modelizmit.

#### De Bruyne: Po na mbysin me ndeshje, UEFA-s dhe FIFA-s u interesojnë vetëm paratë

Kevin De Bruyne i ka sulmuar UEFA-n dhe FIFA-n për numrin e lartë të ndeshjeve të luajtura gjatë sezonit. Mesfushori i Belgjikës dhe Manchester Cityt, duke folur në një konferencë për shtyp para ndeshjes kundër Izraelit, nënvizoi me tone të larta: "Me Botërorin e Klubeve të vitit të ardhshëm do të ketë tri javë distancë midis finales dhe fillimit të Premierë Ligës. Tri javë pushime dhe përgatitje... Po u afrohem 80 ndeshjeve në sezon. Ka sindikata futbollistësh në Angli dhe gjetkë, që janë përpjekur t'i ndryshojnë gjërat, por nuk është e mundur. UEFA dhe FIFA vazhdojnë në këtë rrugë. Pse? Nuk u intereson shëndeti i futbollistëve. Janë paratë ato që vendosin. Vetëm ato u interesojnë".

#### Frankurti njofton për vdekjen e trajnerit të ekipit U19

Eintracht Frankfurt ka konfirmuar vdekjen e trajnerit të ekipit U19, Helge Rasche. 33-vjeçari e humbi jetën në një aksident me veturë të enjten. Klubi konfirmoi vdekjen e tij përmes një komunikate të lëshuar në rrjetet sociale. "Eintracht Frankfurt është i mërzhitur nga humbja e trajnerit të U19, Helge Rasche. 33-vjeçari e humbi jetën në një aksident trafiku, derisa klubi bashkëndien me familjen e tij dhe shoqërinë në këto çaste të vështira", thuhet në komunikatë. "BILD" raporton se vetura e tij përfundoi jashtë rrugës dhe u përplas me një pemë.

## Lajm i keq për Brazilin dhe Realin, lëndohet Militao

Federata e Futbollit e Brazilit ka konfirmuar se mbrojtësi Eder Militao ka pësuar një lëndim muskular dhe është larguar nga skuadra kombëtare. Kokëdhimbjet për trajnerin e Real Madridit, Carlo Ancelotti, si

duket nuk kanë fund shkaku i lëndimeve të futbollistëve. I fundit që pësoi dëmtim nga lojtarët e "Los Blancos" është mbrojtësi Militao gjatë grumbullimit me kombëtaren e Brazilit. Raporti mjekësor nga

Federata e Futbollit të Brazilit shpjegon se mbrojtësi i Real Madridit ndjeu "dhimbje në kofshën e djathtë pas stërvitjes së së enjtes mbrëma në Qendrën Stërvitore të Atletico Paranaense". Sipas gazetës "Marca", 26-vjeçari

tani pritet të mungojë në ndeshjen ndaj Real Sociedadit pas pushimit ndërkombëtar. Vlerësimet fillestare sugjerojnë një mungesë prej 2-3 javësh për Militaon dhe mund të humbasë deri në pesë ndeshje në të gjitha

garat, përfshirë derbin me Atletico Madridin më 29 shtator. Ndryshe, mbrojtësi brazilian humbi një pjesë të madhe të sezonit 2023/24 pasi pësoi një dëmtim të ligamentit ACL në gusht të vitit të kaluar.



**KOLEGJI - COLLEGE  
BIZNESI**  
Prishtinë

Rr"Motrat Qiriaz" Nr. 29, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, [www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com), [info@kolegjbiznesi.com](mailto:info@kolegjbiznesi.com)

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **17.07.2024**, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:

**SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STUDENTAVE PËR VITIN AKADEMIK 2024/2025**

**01.07.2024 deri më 30.09.2024**

<b>STUDIME BACHELOR</b>	<b>STUDIME MASTER</b>
<b>1.BANKA DHE FINANCA NË BIZNES (BA) - (3 vjeçar)</b> <b>2.MENAXHMENT DHE EKONOMIKS (BA) - (3 vjeçar)</b> <b>3. SHKENCA KOMPJUTERIKE (BA)- (3 vjeçar)</b>	<b>1.MENAXHMENT DHE FINANCA – MA-(2 vjeçar)</b> <b>2. MENAXHIMI I EMERGJENCAVE -MA-(2 vjeçar)</b>

Dokumentat e nevojshme për Aplikim BACHELOR	Dokumentat e nevojshme për Aplikim MASTER
Diplomën e shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar) Certifikatën e përfundimit të shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar) Dëftesat e viteve (klasave) - I, II, III, / X, XI, XII (Original ose të noterizuar) Certifikatën e lindjes, Kopja e letërnjoftimit, Dy foto.	Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar) CV Certifikatën e lindjes Kopjen e letërnjoftimit Dy foto

[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com),  
[info@kolegjbiznesi.com](mailto:info@kolegjbiznesi.com)

**038/045/044- 500 878**  
**049/ 048- 500 – 878**  
**029-230-555 : 044 131027**



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Laren Group" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 810053249.
- Orges Bakalli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. dhjetë të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lendrit Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Arian Hajrizi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE  
SH. A. "PËRPARIMI SH. A. - VUSHTRI"  
Protokollit: 1635/24  
06.09.24

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A., e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 1621/24 të datës 04.09.2024 të Kryeshëfit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A me datë 06.09.2024 shpall:

### KONKURS PUBLIK

#### I. Titulli: Pastrues i Zyrave dhe Objekteve

Numri i ekzekutuesve: 5

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla fillore

Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve

Koeficienti i pagës: 390.00 Euro Bruto

#### Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga eprori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërliken me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së eprorit;
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

#### Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

#### > Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

#### > Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

#### > Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të tij. Shpallja është e hapur nga data 09.09.2024 deri me datë 23.09.2024 në ora 16:00.

#### Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 03.10.2024.
- Afati për ankesë nga data 04.10.2024 deri me datë 07.10.2024.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 17.10.2024.
- Afati për ankesë nga data 18.10.2024 deri me datë 22.10.2024.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 29.10.2024.
- Afati për ankesë nga data 30.10.2024 deri me datë 01.11.2024.

- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatën e suksesshëm është më së largu 05.11.2024.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

#### > Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: [hrperparimi@gmail.com](mailto:hrperparimi@gmail.com).

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

#### > Përfundim

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE  
SH. A. "PËRPARIMI SH. A. - VUSHTRI"  
Protokollit: 1635/24  
06-09-24

U prilog članu 8, članu 10 pod st. 2.2 i člana 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 01.12.2010, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, i član 8. st. 4, član 11, član 21 pod st. 2.2 i člana 25 Uredbe br. 55/21 o radnim odnosima NPL "Përparimi" Sh. A. u Vučitrnu, odobreno 21.12.2021 od strane Borda direktora NPL "Përparimi" Sh. A., a na osnovu rješenja br. Protokola 1621/24 od 04.09.2024. godine glavnog izvršnog direktora, NPL "Përparimi" Sh. A od 06.09.2024 saopštava:

### JAVNI KONKURS

#### I. Naslov: Čistač kancelarija i objekata

Broj izvršilaca: 5

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje termina: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.

Stručna priprema: Osnovna škola

radno iskustvo: Nije potrebno radno iskustvo

Izvršavač: Rukovodioci Jedinice za održavanje - Čišćenje kancelarija i objekata

Koeficijent plate: 390.00 Euro Bruto

#### Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Čistiće kancelarije i objekte u zavisnosti od ugovora koje poslodavac ima sa trećim licima;
- Čuvaće radni alat koji se koristi za čišćenje;
- Očistiće sve prostore za koje je upućen od nadređenog;
- Pridržavaće se pravila higijene i bezbednosti prema uputstvima pretpostavljenog kao i drugih obaveza u vezi sa radnim mestom a na osnovu zahteva pretpostavljenog;
- Obavlja druge poslove na osnovu naloga rukovodstva preduzeća;
- Za poslove koje obavlja odgovoran je rukovodiocu Jedinice za održavanje – čišćenje kancelarija i objekata;

**Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:**

- Prijavni obrazac za NPL "Përparimi" Sh. A – Vuçitrn (skenirane);
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Ekstrakt rođenja; (sertifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrda o krivičnoj osudi koju je izdao Sudski savet Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (uverenje izdato online na platformi e-Kosova će biti prihvaćeno);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

**Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti**

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

**Način vrednovanja kandidata.**

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

**Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.**

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od 09.09.2024 do 23.09.2024 u 16:00 sati.

Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:

- Prethodna verifikacija prijava kandidata najkasnije do 03.10.2024.
- Rok za žalbu je od 04.10.2024. do 07.10.2024.
- Period kada će kandidati polagati pismeni test, i kada će biti obavljena njihova evaluacija, biće najkasnije do 17.10.2024.
- Rok za žalbu je od 18.10.2024. do 22.10.2024.
- Period kada će kandidati obaviti usmeni intervju i kada će biti obavljena njihova procjena biće najkasnije do 29.10.2024.
- Rok za žalbu je od 30.10.2024. do 01.11.2024.
- Objavljivanje konačnih rezultata za uspješnog kandidata najkasnije do 05.11.2024.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se žalba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, pritužba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

**Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima**

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavni formular u Arhivu NPL "Peparimi" Sh. A u gradu Vuçitrnu, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vuçitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uredjenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: [hrperparimi@gmail.com](mailto:hrperparimi@gmail.com).

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijaće se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

**Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.**

**ZAKLJUČAK**

NPL "Preparimi" Sh. A u Vuçitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiču da se prijave.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E MALISHEVËS  
IAAP "LASGUSH PORADECI" KIJEVË



Datë: 06/09/2024

Nr. Prot. 1901/24

IAAP "Lasgush Poradeci" Kijevë  
Adresa: Rruga "Imer Krasniqi" pn.  
[shmplasgushporadeci@gmail.com](mailto:shmplasgushporadeci@gmail.com)

Bazuar në UA NR. 02/2016 të MASHT, për aktivitetet jashtëshkollore, IAAP "Lasgush Poradeci" në Kijevë shpallë:

**OFERTË PËR EKSKURSION**

(Ekskursion 5 ditor jashtë vendit - Shqipëri)

IAAP "Lasgush Poradeci" në Kijevë shpallë ftesë për oferta për përzgjedhjen e agjencionit të udhëtimit dhe akomodimit për organizimin e Ekskursionit 5 ditor në Republikën e Shqipërisë me maturantët për vitin shkollor 2023/24

Kohëzgjatja e ekskursionit do të jetë 4 netë / 5 ditë, me pansion të plotë.

**Agjensioni turistik duhet ti plotësojë këto parakushte:**

1. Kompania (agjensioni) turistik duhet të jetë i licensuar,
2. Të ketë fletëdëshminë e kontrollës teknike të autobusëve sipas procedurave ligjore,
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve,
4. Kompania (agjensioni) turistik duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusëve,
5. Kompania (agjensioni) turistik duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe të ketë dëshmitë (certifikatë pune dhe diplomë të mjeksisë) që i shoqëron nxënësit,
6. Kompania (agjensioni) turistik duhet të ketë dokumentacionin (licensën) e akreditimit të ushqimeve në Shqipëri të nënshkruar dhe të vulosur nga pronari i hotelit,
7. Kontrata në mes të hotelit dhe Kompanis (agjencionit) turistik,
8. Kompania (agjensioni) turistik duhet të prezantojë menynë ditore të ushqimit për secilën ditë të qëndrimit në Shqipëri të nënshkruar dhe të vërtetuar nga pronari i hotelit,
9. Një fletë konfirmim të rezervimit të hotelit përkatës të vërtetuar në mes të kompanisë turistike dhe hotelit me datë të caktuar,
10. Licensa e ballos e vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit, ku nxënësit do të argëtohen,
11. Vertetim i ATK-së,
12. Hoteli ku bëhet akomodimi i nxënësve duhet të ketë shërbimin e sigurimit fizik dhe profesional,
13. Agjensioni duhet ti mbulojë shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumente historike,
14. Të kihet parasysh numri i nxënësve të vendosur nëpër dhoma.

Kategorizimi do të bëhet në bazë të kriterëve dhe sigurisë ku dhe do të vendoset për ofertën dhe vendin (hotelin) e vendosjes së nxënësve, nga komisioni përkatës ditën e hapjes së ofertave.

**VËREJTJE:** OFERTAT TË CILAT NUK I PËRMBUSHIN KRITERET E KËRKUARA NUK DO TË MERRREN NË SHQYRTIM.

- Afati i aplikimit është 7 ditë nga dita e shpalljes së ofertës,
- Ofertat pranohen në sportelet e DKAE – së në komunën e Malishevës,
- Hapja e ofertave do të bëhet në ditën e fundit të aplikimit duke filluar nga ora 14:00 në shkollë.



Kijevë: 06/09/2024

Ud. Drejtori. Msc. Burim Gashi

*Burim Gashi*

**NJOFTIM MBI ZVOGLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË****ContourGlobal Kosovo L.L.C.**

NUI: 810093039

Në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Kartës së Shoqërisë të plotësuar dhe ndryshuar, Aksionari i shoqërisë "ContourGlobal Kosovo" L.L.C. me seli në Prishtinë, Rr. Lidhja e Pejës, Nr. 177, Kati 5, me numër unik identifikues 810093039 ("Shoqëria") ka nxjerr:

**VENDIM PËR ZVOGLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË NR. 04/2024**

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet për shumën prej 19,570,000.00 Euro, duke e reduktuar nga vlera e regjistruar prej 32,181,000.00 Euro në 12,611,000.00 Euro. Ky vendim është marrë në përputhje me nenin 147 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Të gjithë kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që brenda një afati prej 21 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor t'i drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose për të kundërshtuar zvogëlimin e kapitalit. Kërkesat duhet të dërgohen me postë të rregullt në adresën:

**ContourGlobal Kosovo L.L.C.**

Rr. Lidhja e Pejës, Nr. 177, Kati 5

10000 Prishtinë, Kosovë

\*\*\*

**NOTICE OF REDUCTION OF COMPANY CAPITAL****ContourGlobal Kosovo L.L.C.**

NUI: 810093039

In accordance with the requirements of Law No. 06/L-016 on Business Organizations in Kosovo and the amended and restated Charter of the Company, the Shareholder of "ContourGlobal Kosovo" L.L.C. with headquarters in Pristina, Rr. Lidhja e Pejës, Nr. 177, 5th Floor, with unique identification number 810093039 (the "Company") has issued the following:

**DECISION ON REDUCTION OF COMPANY CAPITAL NO. 04/2024**

The company's capital is reduced by the amount of 19,570,000.00 Euros, decreasing from the registered value of 32,181,000.00 Euros to 12,611,000.00 Euros. This decision is made in accordance with Article 147 of the Law on Business Organizations. All creditors of the Company have the right to address the Company with a request for additional security or an objection to the capital reduction within 21 days from the date of publication of this notice in the daily press. Requests should be sent by regular mail to the address:

**ContourGlobal Kosovo L.L.C.**

Rr. Lidhja e Pejës, Nr. 177, 5th Floor

10000 Pristina, Kosovo

\*\*\*

**OBAVEŠTENJE O SMANJENJU KAPITALA DRUŠTVA****ContourGlobal Kosovo L.L.C.**

NUI: 810093039

U skladu sa zahtevima Zakona br. 06/L-016 o privrednim društvima na Kosovu i izmenjenom i dopunjenom Statutom Društva, Akcionar društva "ContourGlobal Kosovo" L.L.C. sa sedištem u Prištini, Rr. Lidhja e Pejës, br. 177, V sprat, sa jedinstvenim identifikacionim brojem 810093039 ("Društvo") donosi:

**ODLUKU O SMANJENJU KAPITALA DRUŠTVA BR. 04/2024**

Kapital društva se smanjuje za iznos od 19.570.000,00 evra, smanjujući se sa registrovane vrednosti od 32.181.000,00 evra na 12.611.000,00 evra. Ova odluka je doneta u skladu sa članom 147 Zakona o privrednim društvima. Svi poverioci Društva imaju pravo da u roku od 21 dana od dana objavljivanja ovog obaveštenja u dnevnoj štampi obrate Društvu sa zahtevom za dodatno obezbeđenje ili prigovorom na smanjenje kapitala. Zahtevi se šalju poštom na adresu:

**ContourGlobal Kosovo L.L.C.**

Rr. Lidhja e Pejës, br. 177, V sprat

10000 Priština, Kosovo

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "SN Metal Technology" Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811863340 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "SN Metal Technology" D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811863340 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all customers that the limited liability "SN Metal Technology" L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811863340 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Thirrja për aplikim  
(DHËNJE TË OFERTËS)**

"SABRI R. IBISHI" B.I. emër tregtar "VËLLEZËRIT IBISHI AA" me Nr.Unik.Biznes:812176833 me seli në fshati Vërbicë e Zhegocit p.n. Komuna Gjilan ( Vend Investim - fshati Vërbicë e Zhegocit, rruga Ibishovit p.n. Komuna Gjilan) me pronar SABRI IBISHI, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për mallrat/punët/shërbime këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre Puneve dhe materialit Ndërtimor:

1. Ndërtimi i Shtallës dhe Dhomes së qumështit për Lopë Qumështore 35x12 m;
2. Ndërtimi i Hangarit 14 x 7 x 5 m;
3. Ndërtimi I Gropës septike (pleh) të langët 7x 5x 2 m;
4. Ndërtimi i Gropës septike(pleh) të ngurt 10x5x0-1.6 m.

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek "SABRI R. IBISHI" B.I. (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë (5 ditë nga data e publikimit)

Afati i dorezimit të Ofertave 10 ditë nga data e pranimit te ftesave per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: fshati Vërbicë e Zhegocit, rruga Ibishovit p.n, Komuna Gjilan.  
Për Informata Shtesë tel: +383 45 281 822 dhe në email adresën: aulonaibishi06@gmail.com





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales







# TRADITË QË NGA 1992

